



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh. a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J. S. C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D. D.

Formulari i Kontratës për Furnizim

Konsumatorët shtëpiak

## KONTRATË PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT SHTËPIAK

Kjo kontratë është lidhur ndërmjet **Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A. (KEK SH.A.)- Divizioni për Furnizim** (tani e tutje "Furnizuesi") me adresë:

dhe të cilën e përfaqëson personi zyrtar: \_\_\_\_\_,

dhe "Konsumatorit" me shënimet si në vijim:

Emri i Konsumatorit:	
Mbiemri i Konsumatorit:	
Emri i babait të Konsumatorit:	
Adresa e shërbimit të Konsumatorit: (numri i shtëpisë/banesës, emri i rrugës, qyteti/fshati)	
Adresa e faturimit: (nëse është e ndryshme nga adresa e konsumatorit) (numri i shtëpisë/banesës, emri i rrugës, qyteti/fshati)	
Nr. i Letërnjoftimit të konsumatorit:	
Numri i telefonit:	
E-mail adresa:	
Grupi tarifor:	
Shifra e Konsumatorit në KEK-Furnizuesi: (nëse është konsumator ekzistues)	
Niveli i tensionit: Fuqia maksimale (kW):	
<u>Të dhënat e llogarisë bankare</u> Emri i bankës: Numri i llogarisë:	

## TERMAT DHE INTERPRETIMET

Termat e përdorur në këtë Kontratë janë në pajtim me termat e përdorura në Ligjin për Energjinë, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullën mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, Rregullën mbi procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë, Metodologjinë e tarifave në sektorin e energjisë elektrike, Kodin e shpërndarjes etj.

### 1. OBJEKT I KONTRATËS

Objekt i kësaj Kontrate është furnizimi me energji elektrike nga Furnizuesi për konsumatorët shtëpiak.

### 2. KRITERET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME

- 2.1 Kjo Kontratë i përcakton kriteret dhe kushtet për furnizim dhe shitje-blerje të energjisë elektrike ndërmjet Furnizuesit dhe Konsumatorit.
- 2.2 Furnizuesi dhe Konsumatori pas nënshkrimit të kësaj kontrate obligohen të zbatojnë ligjet dhe rregullat në fuqi në sektorin e energjisë dhe çdo legjislacion tjetër të zbatueshëm në Kosovë.
- 2.3 Ligjet, rregullat dhe të gjithë procedurat tjera në fuqi lidhur me energjinë elektrike, pala e interesuar mund t'i gjejë te Furnizuesi.

### 3. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E KONSUMATORIT:

- 3.1 Konsumatori ka të drejtë:
  - a) të furnizohet me energji elektrike nga Furnizuesi ashtu siç është përcaktuar në këtë kontratë, në Rregullën mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, në Marrëveshjen për kyçje, si dhe të ketë shërbime cilësore dhe furnizim sipas Standardeve në fuqi.
  - b) të kompensohet në rast të mos-përmbushjes së cilësisë së shërbimit dhe furnizimit me energji elektrike, të paraparë sipas Standardeve në fuqi.
- 3.2 Konsumatori ka obligim:
  - a) të shfrytëzojë energjinë elektrike vetëm në përputhje me këtë Kontratë;
  - b) të përmbahet nga çdo shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike, dëmtim të pikës matëse apo pajisjeve për matje;
  - c) të paguaj faturat, sipas tarifave në fuqi, brenda afatit të përcaktuar në rregullat dhe procedurat në fuqi, për të gjithë energjinë e konsumuar;
  - d) të informojë menjëherë Furnizuesin për çdo ndërrim të të dhënave të përfshira në këtë kontratë si: adresa, numri i telefonit, numri i llogarisë bankare etj.;

- a) të pranojë të gjithë obligimet financiare që ndërlidhen me faturimin e konsumit të energjisë elektrike të përbashkët (ashensorët, ndriçimi i shkallëve, korridoreve, etj., atje ku ka);
- b) t'u sigurojë nëpunësve të autorizuar të Furnizuesit qasje të lirë në pikën-lokacionin matës, e cila i referohet Marrëveshjes për kyçje të Konsumatorit;
- c) të mos bëjë shpërndarjen/shitjen e energjisë elektrike në lokacione tjera jashtë adresës së shërbimit të përcaktuar me Kontratë, ndonjë personi apo entiteti tjetër.

#### **4. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E FURNIZUESIT**

Furnizuesi ka të drejtë dhe obligim:

- a) të furnizojë Konsumatorin me energji elektrike sipas Marrëveshjes për kyçje;
- b) të sigurojë lexim të rregullt dhe të saktë të energjisë elektrike të konsumuar (nëse ka kontratë me OSSH-në);
- c) të sigurojë faturim të rregullt dhe të saktë të energjisë elektrike të konsumuar;
- d) t'i ofrojë Konsumatorit njoftim të menjëhershëm, nëse ka ndërprerje të planifikuar të furnizimit me energji elektrike, në pajtim me Standardet e kualitetit;
- e) të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta informuar Konsumatorin në rast të ndonjë ndërprerje të pa-planifikuar/emergjente, duke përfshirë edhe informatën lidhur me arsyet e ndërprerjes dhe kohën që pritët të rikthehet furnizimi, e në përputhje me Standardet e kualitetit në fuqi;
- f) të kthejë furnizimin me energji elektrike pas ndërprerjes, sa më shpejt që është e mundur, e në pajtim me Standardet e kualitetit në fuqi; dhe
- g) të mbledhë dhe monitorojë të dhënat gjegjëse lidhur me konsumin e energjisë elektrike nga ana e Konsumatorit dhe të njoftojë atë mbi parregullsitë e vërejtura të konsumit të tij;
- h) të kompensohet për çfarëdo dëmtimi apo humbjeje të vërtetuara e të shkaktuara nga Konsumatori, si rezultat i shkeljes së dispozitave të Rregullit për shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë. Vlera e një kompensimi të tillë duhet të vendoset në përputhje me procedurat në fuqi.

#### **5. FATURIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE TË KONSUMUAR**

- 5.1 Faturimi i energjisë elektrike të konsumuar llogaritet sipas Tarifave të përcaktuara dhe aprovuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

- 5.2 Faturimi do të bëhet në periudha mujore, duke u bazuar në leximin mujor të njehsorit dhe tarifën për grupin e përcaktuar tarifor, ose në bazë të tarifës afofe (paushallë), aty ku nuk ka pikë matëse ose qasja në pikën matëse është e pamundur.
- 5.3 Në rast të gabimeve që rrjedhin si pasojë e leximit apo faturimit të pasaktë dhe të parregullt, atëherë Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet e nevojshme në faturën vijuese.
- 5.4 Konsumatori njoftohet për datën e leximit të njehsorit në faturën që i dërgohet, të cilën datë Furnizuesi është i detyruar ta respektojë.
- 5.5 Në rast të mos-pagesës së faturës brenda periudhës së lejuar, Konsumatori është i obliguar të paguaj kamatë për shumën e borxhit në normë të caktuar në muaj, sipas normës së interesit të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

## **6. NDËRPRERJET AKSIDENTALE**

Furnizuesi do të bëj informim publik, në pajtim me Standardet e kualitetit në fuqi, për të gjithë ndërprerjet aksidentale siç janë: ndërprerjet për shkak të forcës madhore (vis major), dështim të gjenerimit, sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes.

## **7. NDËRPRERJA E KONTRATËS**

- 7.1 Konsumatori mund ta ndërpresë kontratën kurdo qoftë pa ndonjë arsye, por paraprakisht duhet:
- a) të përbushë të gjitha obligimet kontraktuese ndaj Furnizuesit deri në datën e planifikuar për ndërprerje të kontratës; dhe
  - b) të njoftojë me shkrim Furnizuesin, se paku 3 (tri) ditë kalendarik përpara ndërprerjes së kontratës.
- 7.2 Furnizuesi gjithashtu mund ta ndërpresë kontratën në pajtim me Rregullat dhe Ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

## **8. ANKESAT DHE SHQETËSIMET E KONSUMATORIT**

- 8.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, Konsumatori ka të drejtë të informohet, të kërkojë sqarime, apo të ankohet përkritazi me zbatimin e kësaj kontrate dhe/apo cilësinë e shërbimit që ofrohet në bazë të kësaj kontrate.
- 8.2 Lidhur me piken 8.1 Konsumatori mund të kontaktojë Furnizuesin drejtpërdrejtë, t'i telefonojë Qendrës për Thirrje të Konsumatorëve të Furnizuesit ose përmes postës së rregullt dhe asaj elektronike.
- 8.3 Konsumatori mund të parashtojë ankesë me shkrim, në pajtim me Rregullën mbi procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë.

**9. RUAJTJA E TË DHËNAVE**

Furnizuesi obligohet të ruaj këtë kontratë me të dhëna të konsumatorit, sipas ligjeve në fuqi.

**10. DËMET**

10.1 Sipas kushteve të kësaj kontrate, asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për humbjet që mund të pësojnë me palët e treta, për ndonjë humbje apo vonesë në fitim, për ndonjë humbje apo vonesë në të hyra, për humbjet nga kontratat me palën e tretë apo humbjet tjera indirekte.

10.2 Kontestet që mund të dalin nga kjo kontratë do të zgjidhen në pajtim me Rregullën mbi procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë, procedurat e brendshme të Furnizuesit, dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

**11. HYRJA NË FUQI**

Kjo kontratë hynë në fuqi në datën kur Furnizuesi dhe Konsumatori e nënshkruajnë këtë kontratë. Furnizuesi duhet ta nënshkruaj kontratën me Konsumatorin brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës së Konsumatorit për furnizim me energji elektrike.

**12. FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE**

Furnizimi me energji elektrike do të filloi jo më vonë se pesë (5) ditë pune pasi që të jetë nënshkruar kjo kontratë.

Data e fillimit të furnizimit me energji elektrike:\_\_\_\_\_.

Nënshkrimi i Konsumatorit:	.....
Emri dhe Mbiemri i Konsumatorit: (ju lutem shkruani me shkronja të qarta të shtypit)	.....
Data:	.....

Për dhe në emër të KEK-ut:	.....
Emri dhe numri i punës së punëtorit të KEK-ut:	.....
Data:	.....

